UDHËZIM
Nr. 23, datë 20.8.2015

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10.030 (dhjetë mijë e tridhjetë) lekë në muaj.

2. Masa e përfitimit për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10. 530 (dhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në muaj.

3. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2015 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2015, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4. Udhëzimi nr. 12, datë 20.9.2014, i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2015.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Blendi Klosi